



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 68/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010, “PËR SEKTORIN
MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Titulli i seksionit të dytë të kreut IV ndryshohet si më poshtë:
“Autorizimi i tregtimit dhe veprimtaritë studimore projektuese”

Neni 2

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Veprimtaritë studimore-projektuese

1. Veprimtaritë studimore-projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga persona fizikë ose juridikë, që kanë të punësuar persona të certifikuar në veprimtarinë studimore-projektuese në fushën minerare. Subjektet detyrohen të regjistrojnë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare.

2. Certifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Licencat aktuale për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ruajnë vlefshmërinë e tyre deri në përfundim të afatit për të cilin janë lëshuar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 9.10.2019